



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KLOS

SHPALLJE PUBLIKE – BASHKIA KLOS PËR SHPREHJE INTERESI PËR VENDE TË LIRA PUNE ME KONTRATË SHËRBIMI NË KUADËR TË PROJEKTIT “ME KOMUNITETIN PËR KOMUNITETIN!”

Bashkia Klos prej muajit Korrik 2023, në partneritet me Shoqatën Kreo, ka filluar zbatimin e projektit: ‘Me komunitetin për Komunitetin!’ të bashkë-financuar nga Programi I Fondit Social. Projekti "Me komunitetin për komunitetin" ka si qëllim kryesor ofrimin e shërbimeve cilësore për komunitetin duke u mbështetur në fushën 2,3 dhe 4 të Planit Social të bashkisë Klos që lidhen me fuqizimin e kapaciteteve njerëzore dhe administrative të shërbimeve të kujdesit shoqëror, shërbimet e kujdesit shoqëror dhe programet parandaluese, duke kontribuar në dy nivele:

1- Ofrimin e shërbimeve në komunitet për grupet vunerabël

2-Ofrimin e shërbimit social lëvizës me një staf të specializuar

Mundësimi i një jetese cilësore për banorët e bashkisë Klos do të mundësohet për të gjithë target-grupet në nevojë duke filluar që nga ofrimi i paketave të ndihmës, ofrimi i shërbimit social lëvizës me një staf të specializuar deri tek zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme argëtuese dhe kulturore.

Në kuadër të implementimit të projektit bashkia Klos shpall thirrjet për pozicionet vakante me kontrata shërbimi si më poshtë:

1. **MENAXHER I PROJEKTIT** (Me angazhim 40% e kohës mujore)
2. **FINANCIER I PROJEKTIT** (Me angazhim 15% e kohës mujore)

MENAXHERIT TE PROJEKTIT

Me Kontratë Shërbimi

Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore

Menaxheri i Projektit do të ketë përgjegjësi të mëposhtme:

- Planifikimi, organizimi dhe koordinimi i aktiviteteve të projektit në përputhje me afatet dhe buxhetin e përcaktuar.
- Menaxhimi i ekipit të projektit dhe sigurimi që ata të jenë të përfshirë dhe të motivuar për arritjen e objektivave.
- Monitorimi dhe raportimi i përparësive të projektit ndaj mbikqyrësit të projektit dhe të financave.

- Sigurimi i burimeve dhe resurseve të nevojshme për projektin, përfshirë personelin, materiale, dhe teknologjinë.
- Bashkëpunimi dhe komunikimi i vazhdueshëm me palët e interesuara, kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Menaxhimi i riskut dhe identifikimi i çdo sfide që mund të ndodhë gjatë zbatimit të projektit.
- Mbajtja e komunikimit të vazhdueshëm me donatorin dhe pjesmarrja në aktivitete fundraising për të suportuar bashkinë në arritjen e mundësisë së investimeve në linjë

Kualifikimet dhe Aftësitë e Kërkuara

- Mbi 5 vite përvojë relevante në menaxhimin e projekteve nga donator lokal/kombëtar dhe ndërkombëtar, përfshirë planifikim, monitorim, dhe raportim.
- Njohuri të mira mbi politikën Sociale dhe Planet Sociale Vendore të vërtetuara nga eksperiencat e mëparshme.
- Aftësi të shkëlqyera të komunikimit dhe bashkëpunimit.
- Aftësi organizative të shkëlqyera dhe aftësi të menaxhojë kohën me efikasitet.
- Certifikime kombëtare dhe ndërkombëtare në menaxhimin e projekteve
- Aftësi për të drejtuar dhe menaxhuar projektet.
- Aftësi të mira të kompjuterit dhe njohuri të programeve të zakonshme të kompjuterit.
- Aftësi të flasësh dhe të shkruash në gjuhën angleze, preferohet.
- Përdorimi i Kontratës dhe Pagesa

Menaxheri i Projektit do të punojë në bazë të një kontrate shërbimi me angazhim të përqendruar të kohës (40% angazhim mujor). Pagesa për këtë pozicion do të bazohet në tarifën mujore të caktuar në kontratë dhe do të paguhet në përputhje me orët e punuara në fund të çdo muaji.

Aplikimi

Për të aplikuar për këtë pozicion, të interesuarit duhet të paraqesin një CV, një letër motivimi , 2 letra reference nga punëdhënësi të mëparshëm dhe dokumenta të skanuar që vërtetojnë kualifikimet e marra, në adresat e emailit bashkia.klos@yahoo.com, burimetnjerezore.bashkiaklos@hotmail.com deri më datën **15.09.2023**.

Ju lutemi të përfshini në subjektin e emailit "Aplikim për Menaxher të Projektit". Në aplikimin tuaj, ju lutemi të përfshini një listë të referencave të mundshme.

Afati i Aplikimit

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është më datën **15.09.2023**. Aplikimet e vonuara nuk do të merren në konsideratë.

FINANCIERI I PROJEKTIT

Me Kontratë Shërbimi (15% Angazhim Mujor)

Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore

- Financieri i Projektit do të ketë përgjegjësi të mëposhtme:
- Përgatitjen dhe monitorimin e buxhetit të projektit.
- Regjistrimin dhe monitorimin e të gjitha transaksioneve financiare të projektit.
- Përgatitjen e raporteve financiare periodike për drejtuesit e projektit dhe financuesit.
- Sigurimin e dokumentacionit të plotë dhe të saktë financiar për auditim dhe raportim.
- Përcjelljen e ligjshmërisë dhe zbatimin e politikave dhe procedurave financiare të projektit.
- Bashkëpunimi dhe komunikimi i vazhdueshëm me ekipin e projektit dhe palët e tjera të interesuara.

Kualifikimet dhe Aftësitë e Kërkuara

- Përvojë relevante mbi 10 vjecare në menaxhimin financiar të projekteve, përfshirë përgatitjen e buxhetit dhe monitorimin financiar.
- Aftësi të shkëlqyera të analizës financiare dhe njohuri të mënyrës se si të lexoni dhe interpretoni raportet financiare.
- Certifikimi dhe Licensime që vërtetojnë njohuritë
- Aftësi të shkëlqyera të komunikimit dhe bashkëpunimit.
- Aftësi të mira të kompjuterit dhe njohuri të programeve të zakonshme të kompjuterit.
- Aftësi të flasësh dhe të shkruash në gjuhën angleze, preferohet.

Përdorimi i Kontratës dhe Pagesa

Financieri i Projektit do të punojë në bazë të një kontrate shërbimi me angazhim të përqendruar të kohës (15% angazhim mujor). Pagesa për këtë pozicion do të bazohet në tarifën mujore të caktuar në kontratë dhe do të paguhet në përputhje me orët e punuara në fund të çdo muaji.

Aplikimi

Për të aplikuar për këtë pozicion, të interesuarit duhet të paraqesin një CV dhe një letër motivimi dhe dokumenta që vërtetojnë certifikimit dhe aritjet profesionale, në adresat e emailit bashkia.klos@yahoo.com, burimetnjerezore.bashkiaklos@hotmail.com deri më datën **15.09.2023**.

Ju lutemi të përfshini në subjektin e emailit "Aplikim për Financier të Projektit." Në aplikimin tuaj, ju lutemi të përfshini një listë të referencave të mundshme.

Afati i Aplikimit

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është më datën **15.09.2023**. Aplikimet e vonuara nuk do të merren në konsideratë.

MËNYRA E SHPALLJES SË KANDIDATIT TË PËRZGJEDHUR

Përzgjedhja e kandidatit të përzgjedhur do të bëhet nga një komision i përbërë për këtë qëllim dhe kandidati i përzgjedhur do të shpallet në faqen zyrtare të Bashkisë së Klosit dhe në vendet e tjera të përshtatshme në datën **20.09.2023**.

Ju lutemi të dërgoni aplikimin tuaj të plotë me dokumentacionin e nevojshëm në adresat e emailit bashkia.klos@yahoo.com, burimetnjerezore.bashkiaklos@hotmail.com deri më datën **15.09.2023**.

Bashkia Klos inkurajon të gjithë kandidatët e kualifikuar të aplikojnë për pozicionet e shpallura dhe të rëndësishme për komunitetin. Ju falënderojmë për interesimin tuaj dhe presim me padurim aplikacionet tuaja.